REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	**10.01.2023**
REFERENCË	
PËR:	**z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan**
CC:	**z. Fauz Xhemajli, Nënkryetar i Komunës në Lipjan** **z. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan**
NGA:	**z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan**
LËNDA:	**Raport i punës - Muaji Dhjetor 01.12.2022-31.12.2022**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

DKA edhe gjatë muajit dhjetor ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme:

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Komisioni komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka vazhduar me vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, konform kërkesave nga shkollat.

Raportim në SIA rreth mbajtjen së mësimit ditëve të shtuna në shkollat fillore në Komunën e Lipjanit.

Fillimi i punimeve në realizimin e projektit: Ndërtimi i parqeve dhe lojërave për fëmijë në shkolla fillore në fshatra: Dobrajë e Madhe, Kraishtë, Rubovc, Banullë, Babush i Muhaxherëve, Llugaxhi, Smallushë, Shalë, Krojmir, Topliqan, Baicë, Poturoc, Medvec, Magure, Bujan, Gllogovc, Lipjan-Faza II (kontratë dy vjeqare 2022/2023).

Nënalokimi në kategorinë: paga&mëditje, mallra&shërbime.

Zotimi i mjeteve në kategorinë: mallra dhe komunali.

Regjistrimi i lëndëve për arkivim.

Përmbyllja e të gjitha pagesave.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime–kthim nga lehonia, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim–skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.

STATISTIKAT

Gjatë muajit dhjetor nuk kemi pasur ndonjë statistikë për të paraqitur në raport mujor.

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me përfaqësuesit e UNICEF-it dhe të Ministrisë së financave rreth vazhdimit të bashkëpunimit për mbështetje të edukatoreve në qendrat me bazë në komunitet në Shalë dhe Magure si dhe Çerdhet në Gadime dhe Sllovi rreth angazhimit të asistentëve-praktikantëve në Komunën e Lipjanit,
- Takim me përfaqësuesit e GIZ-it- rreth aktiviteteve që planifikohen të realizohen në vitin 2023 (Orientimi në karrierë, digjitalizimi si dhe aktivitetet për nxënësit me nevoja të veçanta) në kuadër të projektit "Fit for Jobs" me Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan,
- Takim me përfaqësuesit e Forumit të Aftësisë së Kufizuar rreth angazhimit të asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta,
- Takime të ndryshme me qytetarë, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin dhe
- Takime të vazhdueshme me drejtorët e shkollave.

SFIDAT

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t'i vlërësoj të gjithë në kohë reale.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.